



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 101, datë 21.06.2019

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E APELIT{...}

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit {...}, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 278/2, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT{...}

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit {...}, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {...}; në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}; të akuzuar për: “Kalim i paligjshëm i kufirit”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR {...}

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: Përfundim trupit gjykues.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...} (relator), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {...}; në ngarkim të të pandehurve: {...} alias {...}, {...}, {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/2 e 278/1 të Kodit Penal ({...}, alias {...}); neni 283/2 ({...}); neni 283/2 ({...}); neni 283/2 ({...}) të Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; palë e interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {...}; me objekt: Shtyrje ekzekutimi të vendimit.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; palë e interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {...}; me objekt: Heqje zotësie për të vepruar të shtetases {...} dhe caktimin si kujdestare ligjore të {...}

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR {...}

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; me objekt: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR {...}

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}; me objekt: Dëmshpërblim page.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR {...}

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} dhe {...}; të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR